



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E STUDIMEVE, PLANIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT TE INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot.

Shkodër ___/___ 2019

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj Nr 93, Dt 05.02.2019 në lidhje me kërkesën “Dhënie Adrese

Drejtuar: _____

Adresa: _____

Me shkresën tuaj Nr 93, dt 05.02.2019, protokolluar pranë Institucionit tonë me shkresën Nr.1946, dt 07.02.2019, në lidhje me këtë ju informojmë se:

Në vazhdim të korespondencës me ju, referuar shkresës tonë Nr 1719, dt 04.02.2019, me të njëjtin objekt, ju në shkresën tuaj na bëni me dije se jeni në një proces gjyqësor dhe ju jeni në cilësinë e palës mbrojtëse, por ju kujtojmë përveç Ligjit Nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” që ju i referoheni është edhe Ligji Nr 9887 Dt 10.03.2008 ”Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Sa sipër kërkojmë nga ana e juaj ose Institucionit të Drejtësisë që ju i referoheni të na vini në dispozicion Vërtetimin e Gjykatës sipas shkallës që gjykon procesin dhe kërkon të dhënat personale të shtetasve si dhe prokurën që ju keni si palë mbrojtëse në lidhje me këte proces gjyqësor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj.

ZV/KRYETARI

Fatbardh SHEQI